

**VENDIM**  
**Nr. 419, datë 23.7.2025**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 725, DATË 2.9.2015, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË**  
**AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 7/1, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në kreun III, të vendimit nr. 725, datë 2.9.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Agjencia kryen gjithashtu detyrat e mëposhtme:

a) Kryen monitorimin e lejeve të ndërtimit, në kompetencë të KKTU-së, nëpërmjet kontrolleve në terren dhe kontrolleve të sistemeve të kamerave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe përgatit raportin përkatës për të informuar Këshillin Kombëtar të Territorit dhe Ujit e autoritetet e tjera, që kanë përgjegjësi në fushën e zhvillimit të territorit mbi kontrollet përkatëse;

b) Organizon aktivitete, ekspozita, panairë, *expo*, si dhe veprimtari të tjera promociionale, kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit dhe përfshirjes së arkitekturës moderne në zhvillimin urban;

c) Financon/bashkëfinancon projektet që lidhen me zhvillimin e territorit dhe promovimin e arkitekturës moderne dhe inovative.”.

2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**